

**V E N D I M**  
**Nr. 64 Date 13 .06. 2008**

**MBI APLIKIMIN E SHOQERISE “ERS - 08” SH.P.K PER LICENSIMIN NE**  
**AKTIVITETIN E NDERTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTEZIMIT TE**  
**CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERE DHE PRODHIMIN E ENERGJISE**  
**ELEKTRIKE NGA PARKU EOLIK LEZHE**

Në mbështetje të neneve 9; 13 pikat 1, germa a, dhe 8, si dhe 15 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar; neneve 13, pika 1 dhe 2 si dhe 14, te Rregullores per Procedurat e Licensimit, miratuar me Vendimin nr.24, date 04.04.2007, te Bordit te Komisionereve te ERE-s; në mbledhjen e tij të datës 13.06.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria “ERS – 08” Sh.p.k., per tu licensuar ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrike me ere dhe prodhimin e energjise elektrike, nga parku eolik Lezhe,


**Konstatoi se:**

1. Fillimi i procedurave per shqyrtimin e aplikimit te shoqerise ERS-08 sh.p.k ka nisur me marrjen e vendimit nr. 29 date 04.03.2008.
2. Ligji nr. 9913 date 5.5.2008 ” Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nuk mund te kete fuqi prapavepruese per aplikimet e paraqitura para hyrjes ne fuqi te ketij ligji.
3. Ne lidhje me ndertimin e ketij parku eolik, shoqeria ERS- 08 sh.p.k ne aplikimin e saj per tu licensuar ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrike me ere dhe prodhimin e energjise elektrike, nuk ka paraqitur dokumenta qe vertetojne pronesine e aseteve per zonen ku shtrihet Parku eolik Lezhe, duke mos plotesuar nenin 9, pika 2, germa e, te Rregullores per Procedurat e Licensimit, nje nga kushtet baze per ushtrimin e aktivitetit qe kerkohet te licensohet.

Per sa konstatuar, Bordi i Komisionereve te ERE-s,



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve



**Vendosi:**

1. Refuzimin e licensimit të shoqërisë "ERS – 08" shpk, në aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrik me ere, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga Parku eolik Lezhe.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**

**Bujar Nepravishta**